



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.34/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Hajriz Hoti dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbajtjes së tubimeve publike, në kampusin e shkollave të mesme, për qëllime elektorale të subjektit politik LDK, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.34/2025 e datës 14.01.2025

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbajtjes së tubimeve në objekte publike pa autorizim, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 6,000.00(gjashtëmijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 14.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, në të cilën pretendohet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me datë 13 Janar 2025, ka mbajtur tubim elektorale në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë si dhe Rregullores Zgjedhore nr. 07/ 2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, konkretisht neni 36, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, si dhe neni 4 paragrafit 1 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, rrjedhimisht ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore duke shfrytëzuar institucionet e Arsimit, përkatësisht Kampusin e Shkollave të Mesme

në Viti, për tubime publike zgjedhore dhe duke takuar dhe shfrytëzuar punëtorët e institucionit përkatës. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës disa fotografi si prove, që i referohen rrjetit social facebookut të kandidatit për kryeministër nga subjekti politik LDK.

Më datë 15.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 16.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 16.01.2025, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, lidhur me pretendimet se subjekti politik LDK ka shkelur neni 36 paragrafi 1, 2 dhe 3 të LZP, me rastin e mbajtjes së tubimit publik në ambientet e kampusit të shkollave të mesme, konsiderojmë se nuk qëndron, ngase një tubim i tillë është mbajtur në përputhje me nenin e me nenin 4 paragrafi 2 i cili shprehimisht thotë *“Subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubime në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet në institucioni përkatës dhe KKZ”*. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës thekson se në rastin konkret tubimi publik është mbajtur në një institucion arsimor që është në përfundim e sipër çka e lejon Rregullorja respektivisht neni i lartcekur i kësaj rregullore, dhe në përputhje me nenin 44 të LZP-së. Sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë tubimi publik i mbajtur po ashtu është në përputhje me nenin 4 paragrafi 7 dhe nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafin 2.1 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, i cili shprehimisht thotë: *“Në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave si në vijmë punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët pezullojnë vendin e punës”*.

Pra në rastin konkret sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë tubimi publik në fjalë është mbajtur pas orarit të rregullt të punës dhe pa e penguar procesin e punës së përditshëm dhe kësajoi i njëjti tubim publik është në përputhje me kërkesën ligjore të dispozitës së lartcekur të Rregullores Nr.07/2024. Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës potencon edhe Ligjin Nr.08/166 për Tubime Publike, i cili ligj në nenin 25 të tij shprehimisht thotë: *Në rast të mospajtimit të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera që përmbajnë dispozita rreth organizimit të tubimeve dhe ngjarjeve publike, ky ligj do të ketë epërsi*. Andaj meqë ligji për Tubime Publike ka epërsi ndaj LZP-së, sa i përket dispozitave rreth organizimit dhe ngjarjeve publike, parashtruesi i përgjigjes në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon nga PZAP që ta refuzoj ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje-LVV, si të pabazuar.

PZAP i është drejtuar për përgjigje në ankese edhe KQZ-KKZ- Viti, dhe në përgjigje theksohet se sipas paragrafit 2 neni 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, subjektet politike të certifikuara mund të mbajnë tubime në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre, dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ. Në përgjigje nga KQZ po ashtu sipas paragrafit 3 të nenit 4 të kësaj të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, subjekti politik që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në

Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës, dhe lidhur më këtë nga informacioni i pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Vitisë, subjekti politik LDK nuk ka dorëzuar formularin për njoftimin e tubimit politik për tubimin e datës 13 janar 2025, në Kampusin e Shkollave të Mesme, në Viti.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Bazuar në nenin 4 paragrafi 2 të Rregullores 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, e cila shprehimisht përcakton” *Subjektet politike të certifikuara mund të mbajnë tubime në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ*”.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se bazuar në Rregulloren Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, *neni 4 paragrafi 3 thekson se: se subjekti politik që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës, ndërsa nën paragrafi 4 thekson se : KKZ pas pranimit të formularit nga subjekti politik e regjistron në libër të protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohë së pranimit të njoftimit”. KKZ jo më vonë se ora 09:00 në ditën e tubimit e njofton policinë dhe zyrën për qëllime të monitorimit”.*

Andaj bazuar në informacionin e pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Vitisë, vërtetohet se subjekti politik LDK nuk ka dorëzuar formularin për njoftimin për mbajtjen e tubimit politik me datën 13 janar 2025, në Kampusin e Shkollave të Mesme, në Viti. Duke pasur parasysh se subjekti politik LDK, nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë tek KKZ-ja, në Viti për mbajtjen e tubimit me datën 13.01.2025, dhe mbi këtë arsye Paneli ka gjetur se subjekti politik në fjalë ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 3 të Rregullores Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar dhe Paneli gjeti se tubimi i mbajtur të datës 13 janar 2025, në Kampusin e Shkollave të Mesme, në Viti, është mbajtur pa lejen e dhënë nga KKZ në Viti.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes, për nga natyra është i ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku thuhet se Ligji për Tubime Publike, është në epërsi në raport me LZP, Paneli vlerëson se pretendimi është i pabazuar për faktin se LZP, është ligj special në raport me Ligjin për Tubime Publike dhe se ka epërsi në zbatim si në rastin konkret e po ashtu edhe gjatë fushatës zgjedhore.


Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara në fakte dhe në dëshmi të qarta dhe se nga këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 4 paragrafi 3 e Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.34/2025 më datën 16.01.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.9/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolejin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar i kolejit, Lumni Sallauka dhe Franciska Zhitija-Ymeri, anëtarë të kolejit, lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të mbajtjes së tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në Institucionet e Arsimit, përkatësisht Kampusin e Shkollave të Mesme në Viti, pa paraqitjen e Formularit për Njoftimin për Mbajtjen e Tubimit Publik në Komisionin Komunal për Zgjedhje, (KKZ), duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.34/2025, të datës 16.01.2025, në seancën e kolejit të mbajtur më datën 24.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M


PRANOHET pjesërisht e themeltë ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë.

NDRYSHOHET pjesërisht vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.34/2025, të datës 16.01.2025, sa i përket dënimit me gjobë të shqiptuar në lartësi prej 6000 (gjashtëmijë) Euro, dhe VENDOSËT që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, t'i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 3000 (tremijë) Euro.

Vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.34/2025, të datës 16.01.2025, në pjesën tjetër VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin Anr.34/2025, të datës 16.01.2025, ka vendosur: I. Aprovohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Anr.34/2025, të datës 14.01.2025. II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të mbajtjes së tubimeve në objekte publike pa autorizim, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 6,000.00 (gjashtëmijë) euro. III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën –II- të



dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.


Kundër vendimit të lartcekur, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me kohë ka paraqitur ankesë në këtë gjykatë me datën 21.01.2025, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e tij duke theksuar ndër të tjera se: tubimin e ka mbajtur jashtë orarit të punës duke mos penguar procesin e rregullt të punës, në përputhje me nenin 5 par. 2 nën par. 2.1 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024. Ka shtuar se, dënimi me gjobë i shqiptuar është shumë i lartë, me që nuk ka recidivizëm të veprës, ndërsa ka theksuar se PZAP nuk i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese, sepse nuk ka mbajtur sesione informuese me partitë politike për të bërë sqarime lidhur me ligjin e ri në fuqi. Andaj, konteston lartësinë e dënimit me gjobë, të shqiptuar nga PZAP, mbi konstatimin e shkeljes së mbajtjes së tubimit publik, përcaktuar nga neni 4 par.3 të kësaj rregullore, dhe propozon që Gjykata Supreme ta pranoj si të bazuar ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ashtu që, dënimi me gjobë të rishikohet dhe rivlerësohet në kuptim të uljes së lartësisë së gjobës duke u marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese.

PZAP, në përgjigje në ankesë të paraqitur kundër vendimit Anr.34/2025, të datës 16.01.2025, qëndron pranë vendimit të saj të ankimuar si i drejtë dhe Ligjor, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e subjektit ankues jo të bazuar me që sipas përgjigjes së marrë nga KKZ-KQZ Viti vërtetohet se subjekti politik LDK nuk ka dorëzuar formularin për Njoftim për mbajtjen e tubimit politik, me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024, andaj i propozon Gjykatës Supreme që ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.34/2025, të datës 16.01.2025, është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se më datë 14.01.2025, PZAP, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) - dega në Prishtinë, në të cilën pretendohet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), më datë 13 Janar 2025, ka mbajtur tubim elektorale në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 36, paragraf 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë si dhe nenit 4 paragraf 1 Rregullores Zgjedhore nr.07/ 2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, duke shfrytëzuar Institucionet e Arsimit, përkatësisht Kampusin e Shkollave të Mesme në Viti, për tubime publike zgjedhore dhe duke takuar dhe shfrytëzuar punëtorët e institucionit përkatës. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës disa fotografi si provë, që i referohen rrjetit social facebooku të kandidatit për kryeministër nga subjekti politik LDK, dhe si i tillë ky tubim mund të cilësohet i pa autorizuar.



Në përgjigjen në ankesë të datës 16.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e ka kundërshtuar dhe e vlerëson si të pabazuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), duke i konsideruar si të pabazuara pretendimet ankimore me arsyetimin se: tubimi është mbajtur në përputhje me nenin 4 paragraf 2 i cili shprehimisht thotë: *“Subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubime në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo të lejohet në institucioni përkatës dhe KKZ”*. Tubimi publik është mbajtur në një institucion arsimor që është në përfundim e sipër çka e lejon rregullorja respektivisht neni i lartcekur i kësaj rregullore, dhe në përputhje me nenin 44 të LZP-së. Tubimi publik i mbajtur po ashtu është në përputhje me nenin 4 paragraf 7 dhe nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafin 2.1 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, i cili shprehimisht thotë: *“Në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave si në vijmë punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjallë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët pezullojnë vendin e punës”*.

Më tutje ka shtuar se në rastin konkret sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë tubimi publik në fjalë është mbajtur pas orarit të rregullt të punës dhe pa e penguar procesin e punës së përditshëm dhe kësaj i njëjti tubim publik është në përputhje me kërkesën ligjore të dispozitës së lartcekur të Rregullores Nr.07/2024. Po ashtu, potencon edhe Ligjin Nr.08/166 për Tubime Publike, i cili në nenin 25 të tij shprehimisht thotë: *“Në rast të mospajtit të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera që përmbajnë dispozita rreth organizimit të tubimeve dhe ngjarjeve publike, ky ligj do të këtë epërsi”*. Andaj meqë ligji për Tubime Publike ka epërsi ndaj LZP-së, sa i përket dispozitave rreth organizimit dhe ngjarjeve publike, parashtruesi i përgjigjes në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon nga PZAP që ta refuzoj ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje-LVV, si të pabazuar.

PZAP i është drejtuar për përgjigje në ankesë edhe KQZ-KKZ-Viti, dhe në përgjigje theksohet se: sipas paragrafit 2 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, subjektet politike të certifikuara mund të mbajnë tubime në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre, dhe pasi që kjo të lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ. Po ashtu, sipas paragrafit 3 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, subjekti politik që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës, dhe lidhur më këtë nga informacioni i pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Vitisë, subjekti politik LDK nuk ka dorëzuar formularin për njoftimin e tubimit politik për tubimin e datës 13 janar 2025, në Kampusin e Shkollave të Mesme, në Viti.



PZAP pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të kundërshtuar Anr.34/2025, të datës 16.01.2025.


Për mënyrën e vendosje si në aktvendimin e kundërshtuar, PZAP ka arsyetuar se: Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se bazuar në Rregulloren Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, neni 4 paragrafi 3 thekson se: *“Subjekti politik që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë formularin për njoftim për tubim ne Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), jo më vonë se njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës dhe jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më shumë se dyqind (200) pjesëmarrës”,* ndërsa nën paragrafi 4 thekson se: *“KKZ pas pranimit të formularit nga subjekti politik e regjistron në libër të protokollit dhe vendos për miratim sipas datës dhe kohës së pranimit të njoftimit. KKZ jo më vonë se ora 09:00 në ditën e tubimit e njofton policinë dhe zyrën për qëllime të monitorimit”.*

PZAP tutje arsyeton se, bazuar në informacionin e pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Vitisë, vërtetohet se subjekti politik LDK nuk ka dorëzuar formularin për njoftimin për mbajtjen e tubimit politik me datën 13 janar 2025, në Kampusin e Shkollave të Mesme, në Viti. Duke pasur parasysh se subjekti politik LDK, nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë tek KKZ-ja, në Viti për mbajtjen e tubimit me datën 13.01.2025, dhe mbi këtë arsye Paneli ka gjetur se subjekti politik ka mbajtur tubimin publik pa lejen e dhënë nga KKZ në Viti.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përbën përsëritje të shkeljes, për nga natyra është i ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e theksuara në përgjigje në ankesë, lidhur me epërsinë e Ligjit për Tubime Publike në raport me LZP, mirëpo të njëjtat i vlerëson të pabazuara për faktin se LZP, është ligj special në raport me Ligjin për Tubime Publike dhe se ka epërsi në zbatim si në rastin konkret e po ashtu edhe gjatë fushatës zgjedhore. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara në fakte dhe në dëshmi të qarta dhe se nga këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 4 paragraf 3 të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 117 paragraf 3, neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragraf 1.3 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes vlerëson se PZAP, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës me rastin e vendosjes për gjobën ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, por vendimi mbi dënimin me gjobë është përfshirë në zbatim të gabuar të



dispozitave ligjore me referencë në dispozitat e Ligjit 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, 120 paragraf 1 nën paragraf 1.3, lidhur me lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, rrethanat e konstatuara nga PAZP, janë përcaktuese për shqiptimin e dënimit me gjobë ndaj subjektit politik LDK, pasi që me mbajtjen e tubimit elektoral pa njoftim të Komisionit Komunal Zgjedhor në Viti, ky subjekt ka konsumuar shkeljen nga neni 4 paragraf 3 të Rregullores Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar mirëpo dënimi me gjobë i shqiptuar nga PZAP, për shkeljen në fjalë është dënim i lartë, për çka Gjykata Supreme ka vendosur për ndryshimin e vendimit të kundërshtuar.

Duke i marrë në konsideratë të gjitha rrethanat faktike të konstatuar nga PZAP, dhe rrethanat specifike lidhur me lartësinë e gjobës, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, është paraqitur nevoja e ndryshimit të vendimit të kundërshtuar, ngase natyra e shkeljes dhe ndikimi i mundshëm i saj në procesin zgjedhor kanë qenë me efekt minimal në cenimin e standardit, të sigurisë dhe Kodit të Mirësjelljes së subjekteve politike. Natyra e shkeljes është e tillë që nuk ka ndikuar në imazhin e përgjithshëm të zgjedhjeve, sepse tubimi është realizuara gjatë fushatës zgjedhore dhe në këtë tubim subjekti politik LDK, nuk është përfshirë në asnjë shkelje tjetër të denoncuar, përveç shkeljes për mos njoftimin e tubimit elektoral, ndërsa ndikim i këtij tubimi në cenimin e standardeve për mënyrën se si duhet të realizohet fushata zgjedhore është minimal dhe pa ndikim në procesin e mëtejshëm zgjedhor, prandaj gjoba në lartësi prej 3000 (tremijë) Euro, vlerësohet si dënim ekuivalent, me peshën e veprës së kundërligjshme të kryer sipas rrethanave të cekura si më lartë, me bindje se edhe me këtë lartësi të gjobës do të arrihet efekti i sanksionimit tek ky subjekt politik.

Nga parashtrimet si më lartë, dhe në pajtim me nenin 118, pika 4, të Ligjit nr.08/L-228 mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (LZP), u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË

AA.nr.9/2025, datë 24.01.2025

Kryetari i kolegjit
Ragip Namani



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Runëtori i autorizuar
Ovlasteni radnik